



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 13

2003

Mars

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9001 datë 6.2.2003	Për ratifikimin e “Programit të veprimit rajonal “CARDS 2002” ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Europian.....	369
Ligj nr.9002 datë 6.2.2003	Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Europian, në kuadër të programi “CARDS 2002””.....	388
Ligj nr.9003 datë 13.2.2003	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për projektin “Furnizimi me ujë i zonave fshatare të Kavajës II – Zona e Manskurisë””.....	399
Ligj nr.9004 datë 13.2.2003	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për projektin “Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Shqipërinë e Mesme, komponentët Berat dhe Kuçovë””.....	402

L I G J
Nr.9001, datë 6.2.2003

**PËR RATIFIKIMIN E “PROGRAMIT TË VEPRIMIT RAJONAL “CARDS 2002”
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË
KOMUNITETIT EUROPIAN**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Programi i veprimit rajonal “CARDS 2002” ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Europian”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr. 3715, datë 28.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

PROGRAMI VJETOR I VEPRIMIT CARDS RAJONAL

1. Identifikimi

Forma e Programit: CARDS-i Rajonal – Programi vjetor i veprimit 2002

Vendet përfutuese: Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Republika Federale e Jugosllavisë dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM).

Buxheti vjetor: 2002

Alokimi financiar: euro 43,5 M

Linja e buxhetit: B7-541

Baza legale: Rregullorja e Këshillit për CARDS-in (EC) nr.2666/2000, amenduar me Rregulloren e Këshillit (EC) nr.2415/2001 në 10 dhjetor 2001.

Kohëzgjatja: Kontratat e financuara nga ky Program hyjnë në fuqi jo më parë se data e zyrtarizimit të marrëveshjes prej njërit nga nënshkruesit kompetentë (një nga vendet e rajonit të Ballkanit) dhe jo më vonë se data 31.12.2005.

Datat e skadencës: Të gjitha kontratat duhet të mbyllen deri, më 31.12.2005. Të gjitha disbursimet duhet të bëhen deri, më 31.12.2006.

Programimi: 2002

Implementimi: Komisioni European

Vërejtje: Asnjë shpenzim administrativ nuk do të financohet nga ky Program.

2. Përmbledhja e Programit

Programi rajonal i veprimit 2002 reflekton materialin strategjik rajonal të miratuar (RSP) për 2002-2006 dhe Programin indikativ shumëvjeçar (tre vjeçar) (MIP) për 2002-2004.

Sipas MIP-it, ky Program identifikon katër fusha për mbështetje në nivel rajonal si: menaxhimi i integruar i kufijve, ndërtimi i kapacitetit institucional, stabilizimi demokratik dhe

zhvillimi i infrastrukturës rajonale. Brenda këtyre fushave, janë identifikuar gjashtë prioritete kryesore për veprim në vitin 2002 duke u nënndarë në projekte specifike, siç tregohen në pikat 6 dhe 10.

Koordinimi rajonal i strategjive kombëtare të menaxhimit të integruar të kufijve - €1 milion ($\pm 20\%$).

Projekti do të japë asistencë teknike dhe studime për të ndihmuar të pesë vendet e interesuara për të siguruar që strategjitë kombëtare të menaxhimit të integruar të kufijve janë koordinuar efektivisht dhe duke u plotësuar me mbledhje rajonale të zyrtarëve përgjegjës dhe dhënien e këshillave teknike nëpërmjet studimeve.

Mjetet e ndërtimit institucional për procesin e Stabilizim Asocimit (SAP) - €7.4 milion ($\pm 20\%$).

Projektet do të japin asistencë teknike, studime dhe trajnime për të ndihmuar vendet e SAP-it të rrisin efikasitetin dhe efektivitetin e institucioneve të tyre kombëtare për të zbatuar më me efikasitet dhe efektivitet detyrat e tyre si administratë publike.

Bashkëpunimi rajonal në fushën e policisë dhe gjyqësorit - €8 milion ($\pm 20\%$).

Projektet do të japin këshillime teknike, bashkërendim dhe trajnim për të ndihmuar vendet të zgjidhin problemet rajonale në fushat e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, në veçanti në lidhje me emigracionin ilegal, azilin dhe krimin e organizuar.

Rrjeti evropian për zhvillim të qëndrueshëm - €4 milion ($\pm 20\%$).

Projektet do të japin asistencë teknike dhe mbështetje të tjera për të rritur nivelin e bashkëpunimit mjedisor midis vendeve të SAP-it, si dhe midis vendeve të SAP-it dhe BE-së.

Stabiliteti demokratik - €7.6 milion ($\pm 20\%$).

Alokimet e grantit do të nxisin aktivitetet e shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare në nivel rajonal, që forcojnë proceset emergjente demokratike, do të nxisin median e pavarur dhe lehtësimin e kthimit të refugjatëve.

Zhvillimi i infrastrukturës rajonale - €14 milion ($\pm 20\%$).

Projektet do të nxisin integrimin e pesë vendeve në rrjetin më të gjerë të infrastrukturës europiane “nëpërmjet studimeve dhe asistencës teknike ku përfshihet siguria në aviacion dhe aspekte të kontrollit të trafikut ajror”.

3. Përshkrimi i përgjithshëm

Procesi i Stabilizim Asocimit

Bashkëpunimi rajonal

Procesi i Stabilizim Asocimit (SAP) përfshin ndihmën ndaj pesë vendeve për të arritur stabilitet politik, ekonomik dhe social në nivel kombëtar, normalizimin e marrëdhënieve të tyre me vendet e SAP-it dhe fqinjët e vendeve kandidatë dhe rritjen e asociimit me BE-në.

Kryetarët e shteteve të Bashkimit Europian shprehën mbështetjen e tyre për SAP-in në Këshillin Europian të Feiras, në qershor në vitin 2000: “Këshilli Europian konfirmon se mbetet objektiv i tij, integrimi më i plotë i mundshëm i vendeve të rajonit në rrjedhën e përgjithshme politike dhe ekonomike të Europës, nëpërmjet procesit të Stabilizim Asocimit.

Të gjitha vendet që kanë lidhje me këtë proces janë kandidatë potencialë për anëtarësim në BE. Këshilli Europian inkurajon shtetet e rajonit të rrisin bashkëpunimin rajonal ndërmjet tyre.” Nëpërmjet SAP-it, BE-ja ka krijuar një kornizë në të cilën një marrëdhënie e re kontraktuale, që ka të bëjë me lidhjet politike, tregtare e të tjera (Marrëveshjet e Stabilizim Asocimit, MSA dhe një program i dedikuar asistence (CARDS) që ndihmon secilin vend të përparojë me ritmin e vet përmes hapave të mëparshme drejt destinacionit final, që është anëtarësimi në BE. Marrëveshje janë nënshkruar me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Kroacisë. Një mandat negociimi është propozuar me Shqipërinë. Për Bosnjë-Hercegovinën dhe RFJ-në, ngritja e grupeve konsultative Task Force është provuar si mjet efektiv për të ndihmuar autoritetet vendase, të fokusohen në reformat kombëtare dhe ato të orientuara nga BE-ja dhe angazhimin me to në një mënyrë të qëndrueshme, që të sigurojë zbatimin e këtyre reformave me synim negociimin e një Marrëveshjeje Stabilizim Asocimi.

Samiti i Zagrebit në vitin 2000 vendosi vulën për SAP-in duke arritur një marrëveshje me 5 vendet e përfshira në lidhje me objektivat dhe kushtet. Deklarata e Samitit shprehu në mënyrë të veçantë se “afrimi me Bashkimin Europian do të shkojë dorë pas dore me këtë proces të zhvillimit të

bashkëpunimit rajonal”.

Modeli i bashkëpunimit rajonal është tërësisht një zgjerim i vetë filozofisë së BE-së se bashkëpunimi më i thellë me vendet fqinje është një rrugë drejt stabilitetit kombëtar si dhe rajonal dhe rritjes dhe, se ky lloj bashkëpunimi i shërben interesave të përbashkëta të vendeve të përfshira.

Vullneti i çdo vendi për të ngritur marrëdhënie të mira me fqinjët e tij duhet të jetë kyçi përcaktues për gatishmërinë për t’u afruar qëllimit për anëtarësim në BE. Këto marrëdhënie rajonale mund të përkufizohen si një seri objektivash të qarta politike:

1) Të sillen me njëri-tjetrin dhe të punojnë me njëri-tjetrin në një mënyrë të krahasueshme me marrëdhëniet politike që ekzistojnë tani midis vendeve anëtare të BE-së.

2) Të nxisë bashkëpunimin direkt midis vendeve të SAP-it për t’u marrë me kërcënimet e përbashkëta që vijnë nga krimi i organizuar, emigrimi ilegal dhe forma të tjera të trafikimit. Në shumë raste (p.sh. politika e vizave dhe menaxhimi i kufijve) është e nevojshme një rrugë e përbashkët për të gjitha vendet në mënyrë që të luftojnë këto kërcënime efektivisht.

3) Të ndërtojë një rrjet marrëdhëniesh të ngushta kontraktuale, “konventat e bashkëpunimit rajonal” përmendur në Zagreb, ndërmjet nënshkruesve të MSA-ve. Me kohë, këto konventa bilaterale me nënshkrueset e tjera të MSA-së do të thellojnë bashkëpunimin ndërmjet vendeve të rajonit, dhe ndërmjet tyre dhe BE-së nëpërmjet:

a. marrëveshjeve bilaterale të tregtisë së lirë në linjë me rregullat e OBT-së dhe bazuar në liberalizimin e vazhdueshëm asimetrik të tregtisë me BE-në;

b. marrëveshjeve reciproke në lidhje me lëvizjen e punëtorëve, vendosjen, dhënien e shërbimeve, pagesat korente dhe lëvizjen e kapitaleve, dhe përafrimin progresiv të politikave kombëtare me *acquis communautaire*;

c. bashkëpunimit në fusha të tjera si: drejtësia dhe çështjet e brendshme dhe kthimi i refugjatëve.

4) Për të riintegruar vendet e SAP-it në rrjetin e infrastrukturës europiane, domethënë për transportin, menaxhimin e kufijve dhe energjinë, dhe në rrjetin më të gjerë europian, siç janë mbrojtja e ambientit dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Dokumenti strategjik rajonal CARDS

Rreth 10% e fondeve të disponueshme të CARDS-it do të drejtohen për të mbështetur dimensionin rajonal për SAP-in si një shtojcë e pesë dokumenteve strategjike të vendit CARDS, ku fokusohen problemet e tjera me ato të natyrës kombëtare që këto vende përballen.

Dokumenti strategjik rajonal CARDS paraqet kornizën strategjike për programimin e kësaj mbështetjeje të nivelit rajonal.

Bazuar në një analizë të detajuar të sfidave rajonale me të cilat këto vende përballen, strategjia nënvizon reagimin e programit rajonal CARDS në katër fusha të identifikuara për mbështetje në nivel rajonal, domethënë: menaxhimi i integruar i kufijve, ndërtimi i kapacitetit institucional, stabilizimi demokratik dhe zhvillimi i infrastrukturës rajonale. Këto janë përzgjedhur duke u bazuar në kontributin e bashkëpunimit rajonal ose, sepse kjo lloj mbështetje mund të ofrohet më mirë në nivel rajonal.

Strategjia rajonale ka si aneks Programin indikativ shumëvjeçar (MIP) për periudhën 2002-2004, që paraqet detaje të mëtejshme mbi programet e mbështetjes rajonale të propozuara. Projektpropozimi që rrjedh nga strategjia dhe MIP-i i saj, prezanton programin e detajuar që do të zbatohet në vitin 2002.

Mbështetja e CARDS-it rajonal kundrejt asaj të CARDS-it kombëtar

Pjesa më e madhe e mbështetjes CARDS për vendet do të financohet nëpërmjet programeve kombëtare të mbështetjes CARDS. Eksperiencia nga PHARE dhe programe të tjera të Komunitetit kanë treguar se kjo shtojcë siguron një nivel më të lartë angazhimi dhe pronësie kombëtare, drejtim dhe ndikim më të mirë të projekteve dhe efikasitet më të madhe në zbatim.

Megjithatë, Komisioni Europian ka konkluduar se duke plotësuar këtë trajtim bazë kombëtar me një program rajonal CARDS do të sigurojë arritjen e objektivave të tij, sepse ose: (i) problemi i adresuar është me të vërtetë ndërkufitar dhe kërkon një bashkëpunim aktiv rajonal midis qeverive të SAP-it, në qoftë se duhet korrigjuar; ose (ii) rezultate të dukshme arrihen në aspektin e efikasitetit ose ndikimit më të fortë, kur zbatimi bëhet nëpërmjet një programi rajonal, në vend të pesë programeve kombëtare.

Ky propozim financiar arrin shumën € 43.5 milion. Këtu nuk përfshihen aktivitetet e

menaxhimit të integruar të kufijve që janë programuar në nivel rajonal, por fondet i janë shtuar secilit program kombëtar dhe zbatohen nëpërmjet kanaleve tradicionale të programit kombëtar.

4. Asistenca e Komunitetit European në të kaluarën dhe koordinimet me donatorët e tjerë.

Koordinimi dhe tërheqja reciproke janë të një rëndësie të madhe në këtë rajon, si edhe brenda këtij sektori të veçantë, duke pasur parasysh numrin e madh të aktorëve të përfshirë. Komisioni e siguron këtë nëpërmjet një pune gjithëpërfshirëse si në nivel ndërkombëtar ashtu edhe brenda vetë vendeve.

Për shembull: Komisioni bashkëkryeson dhe drejtohet nga grupi drejtues i nivelit të lartë për Europën Juglindore që jep drejtim të përgjithshëm në lidhje me koordinimin e donatorëve. Komisioni gjithashtu mban një zyrë të përbashkët me Bankën Botërore për të ndihmuar në koordinimin dhe zhvillimin e mbështetjes rajonale. Përveç kësaj, komisioni luan një rol aktiv dhe udhëheqës në Paktin e Stabilitetit për Europën Juglindore. BE-ja udhëhoqi në vitin 1999 komunitetin ndërkombëtar për të ngritur Paktin, që tani është bërë një motor i rëndësishëm, nëpërmjet të cilit aktorët e përfshirë kombëtarë dhe ndërkombëtarë mund të koordinojnë dhe të fokusojnë më mirë punën e tyre. Duke vazhduar të marrë pjesë në mënyrë aktive në të gjitha tavolinat e punës së Paktit të Stabilitetit, Komisioni do të sigurojë më tej tërheqjen reciproke dhe plotësimin e veprimeve të tij me ato të qeverive kombëtare dhe komunitetin ndërkombëtar.

BE-ja do të sigurojë koordinimin e përgjithshëm midis vendeve të tij anëtare dhe donatorëve të tjerë, partnerëve zbatues dhe vendeve përfutuese për një interes total të përbashkët dhe përdorim më të mirë të fondeve të disponueshme.

Menaxhimi i integruar i kufijve

Koordinimi dhe interesi reciprok është i një rëndësie të madhe për këtë sektor të veçantë, duke pasur parasysh numrin e madh të aktorëve përfshirë në të. Komisioni e siguron këtë nëpërmjet një pune gjithëpërfshirëse si në nivel ndërkombëtar ashtu edhe brenda vetë vendeve.

Duhet të garantohet një koordinim i ngushtë midis programeve kombëtare CARDS, dhe qëllimi i projektit të tanishëm, si dhe të tjerë, është sigurimi i këtij koordinimi.

Ky projekt plotëson gjithashtu një tjetër projekt CARDS rajonal 2002, në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme që do të thotë: “Kooperimi rajonal midis gjyqësorit, policisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit.” Duhet të sigurohet një koordinim i ngushtë midis dy projekteve.

Një nga aktivitetet koordinuese më domethënëse është siguruar nga delegacionet e Komisionit, dhe kur është e mundur nga Agjencia Europiane për Rindërtim, të cilët organizojnë mbledhje në mënyrë të rregullt me vendet anëtare, autoritetet kombëtare dhe organizata të tjera të interesuara (si Institucionet Financiare Ndërkombëtare IFI) për të siguruar programimin, monitorimin dhe koordinimin e përgjithshëm në vazhdim të të gjithë ciklit të programit.

Këto mjete duhet të jenë të afta për të siguruar një ndarje të qartë të punës ndërmjet Komisionit dhe donatorëve të tjerë dhe Institucioneve Financiare Ndërkombëtare në rajon, si dhe në projekte të ndryshme.

Është në veçanti e rëndësishme të inkurajojë dhe të sigurojë një koordinim me aktivitete të Bankës Botërore nën lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Europën Juglindore (TTFSE), i cili ka si qëllim forcimin dhe modernizimin e administratës doganore dhe agjencive të tjera të kontrollit kufitar në rajon.

Gjithashtu edhe Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore ka aktivitete në vazhdim, të lidhura ngushtë me ato nën këtë projekt të propozuar të CARDS-it, dhe për këtë kërkon koordinim të ngushtë. Iniciativat kryesore në këtë sektor përfshijnë:

- Iniciativat e migrimit dhe azilit (MAI).

- Task Forca për ruajtjen e kufijve.

- Task Forca për trafikimin e qenieve njerëzore.

Mbështetja e përgjithshme (General Support Facility GSF)

GSF-ja do të bashkëpunojë ngushtë dhe do të koordinojë veprimet e saj me organizata të tjera, që mbështesin me seminare dhe këshillime vendet kandidatë në lidhje me acquis, për të siguruar plotësimin e programeve të tyre dhe për të shmangur përplasjen e aktiviteteve.

Të sigurojë koordinimin në përgjithësi dhe aktivitetet e planifikuara në kuadër të GSF-së do t'u dërgohen për komente agjencive përkatëse të zbatimit në këto vende, për programet kombëtare

CARDS dhe në OECD për mbështetjen e SIGMA-s.

E drejta e pronësisë industriale dhe intelektuale

Nuk ka mbështetje të mëparshme të BE-së në nivel rajonal për këtë fushë.

Një projekt kombëtar për pronësinë intelektuale është programuar për Kroacinë në kuadër të CARDS 2001 dhe mbështetje kombëtare për zbatimin e klasifikimit të EPOs në FYROM në kuadër të CARDS 2002, me të cilat duhet të bashkëpunojë ky projekt.

Infrastruktura e cilësisë

Nuk ka mbështetje të mëparshme të BE-së në nivel rajonal për këtë fushë.

Drejtësia dhe çështjet e brendshme: bashkëpunimi rajonal në fushën e policisë dhe gjyqësorit

Donatorë të tjerë po mbështesin riaktivizimin e NCB Interpol për rajonin: vetë OIPC Interpol, por gjithashtu në mënyrë bilaterale disa vende anëtare ose vende të treta, japin asistencë direkte financiare dhe asistencë teknike.

Donatorë të tjerë po mbështesin riaktivizimin e NCB Interpol për rajonin: vetë OIPC Interpol, por gjithashtu në mënyrë bilaterale disa vende anëtare ose vende të treta, japin asistencë në fushën e teknologjisë së informacionit ose asistencë direkte financiare.

Koordinimi me të tjerët do të sigurohet, duke përfshirë hyrjen e DFID-së së Britanisë së Madhe në strategjinë e drejtësisë.

Më përgjithësisht, ky projekt do të koordinohet duke pasur parasysh iniciativat ndërkombëtare në këtë fushë, si ato të Paktit të Stabilitetit (tabela 3) dhe SECI Qendra e Bukureshtit për të luftuar krimin ndërkufitar.

Vazhdimësia e aktiviteteve mbështetëse të Programit rajonal të rindërtimit mjedisor (REREP)

Në kuadër të REREP-it (ky projekt është një kontribut i Komisionit Europian për programin e përgjithshëm), është ngritur një rrjet koordinimi për donatorët. Së bashku, donatorët bilateralë kontribuojnë rreth 17 Meuro për çështjet mjedisore prioritare. Disa janë të bashkëfinancuara me Komisionin Europian, ndërsa të tjerët janë të financuara veçan; tërësisht, ky rrjet informal mundëson koordinimin e programeve të ndryshme bilaterale midis komunitetit të donatorëve.

Forcimi i kapaciteteve në vendet e Ballkanit në raportimin mjedisor dhe zhvillimit të rrjetit EIONET

Projekti i tanishëm është vazhdimësi e dy projekteve të mëposhtme të financuara nga Obnova dhe Phare:

1. Vazhdimësia e monitorimit dhe vlerësimit mjedisor në Bosnjë-Hercegovinë dhe FYROM, me shtrirje në Kroaci – Programi i veprimit rajonal për rindërtimin mjedisor për Ballkanin, 29.8.2001 – 28.2.2003, 0.7 Meuro.

2. Vazhdimësia e punës ndërmjet Agjencisë Europiane të Mjedisit dhe Shqipërisë, dhe me shtrirje në Republikën Federale të Jugosllavisë, prill 2002 – shtator 2003, 0.5 Meuro.

Projekti aktual i mbledh vendet në një projekt uniform dhe plotëson arritjet e dy projekteve të përmendura më lart.

Stabiliteti demokratik

Në mënyrë që të lehtësohet kthimi ndërkufitar, po fillon bashkëpunimi ndërkombëtar i qeverive të SAP-it, veçanërisht në vitin 2001 me axhendën për veprim rajonal, një marrëveshje trilaterale midis Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë dhe RFJ-së mbi kthimin e refugjatëve.

Ky projekt plotëson një tjetër projekt CARDS rajonal-2002 në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, që është: “Kooperimi rajonal midis gjyqësorit, policisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit.”

Do të sigurohet një koordinim i ngushtë ndërmjet këtyre iniciativave dhe projekteve. Koordinimi në këtë fushë është i një rëndësie të veçantë, sepse janë tri instrumente operuese të Komunitetit (p.sh. CARDS kombëtar, CARDS rajonal dhe EIDHR), si dhe ka mbështetje të konsiderueshme nga pjesëtarë të tjerë të komunitetit ndërkombëtar.

Gjatë koordinimit ndërmjet mbështetjes së CARDS-it rajonal dhe asaj të EIDHR-së, është shumë e rëndësishme të shmangësh përplasjen. E njëjta Drejtori e Përgjithshme (DG) e Komisionit do të zbatojë si CARDS-in rajonal ashtu edhe mbështetjen e EIDHR-së në këtë fushë, duke e thjeshtuar detyrën e koordinimit.

Për të siguruar që projektet e financuara nga CARDS-i rajonal të mbeten me të vërtetë plotësuese për veprimet e propozuara në kuadër të EIDH-it dhe programit kombëtar CARDS, të gjitha projektet e propozuara për financim, në kuadër të programit rajonal CARDS, do t'u dërgohen

delegacionit të KE-së ose agjencive zbatuese të CARDS-it, EIDHR-it në rajon dhe në selitë qendrore për informacion dhe koordinim.

Duke pasur parasysh aktivitetet e gjera të donatorëve të tjerë në këtë fushë, Komisioni do të vendosë si prioritet ruajtjen e koordinimit të ngushtë të donatorëve nëpërmjet tavolinës së punës 1 të Paktit të Stabilitetit dhe nëpërmjet mekanizmave të tjerë koordinues, si aktivitetet në fjalë për rajonin.

Aktivitete të ndryshme të kohëve të fundit, në kuadër të programit SIGMA, kanë si qëllim dhënien e asistencës për reformën në administratën publike në vendet partnere dhe plotëson aktivitetet nën këtë program.

Donatorë të tjerë, veçanërisht Holanda dhe Danimarka, tashmë janë duke dhënë mbështetje për shoqërinë civile mjedisore në kuadër të REREP-it.

Mekanizmat e REREP-it ndihmojnë në koordinimin e aktiviteteve të donatorëve në fushën e zhvillimit mjedisor. Kjo do të sigurojë që mbështetja për zhvillimin e OJQ-ve do të koordinohet me kontributet e tjera kyç për këtë sektor.

Pellgu ujor i lumit Danub

Formati i këtij projekti plotëson eksperiencën e suksesshme të Programit të përbashkët mjedisor (JEP) të financuar deri tani nga TACIS i vitit 1999, i cili ka një alokim prej 6 Meuro me një bashkëpunim të ngushtë, në fillim me Bankën Botërore dhe më pas me Nefco-n dhe BERZH-in, për të nxitur hua specifike me studime dhe përgatitje projektesh që nevojiten për të mbyllur marrëveshjen për huanë. JEP-i ka tashmë një ndikim dhjetë herë më të madh, sesa pesha e tij në hua të firmosura në rajon.

Projekti do të koordinohet me grupin drejtues të infrastrukturës për Europën Juglindore, që kryesohet nga Komisioni Europian.

Zhvillimi dhe zbatimi i një plani veprimi për tregun rajonal të gazit natyror në Europën Juglindore.

Vëmendje i duhet dhënë studimeve dhe analizave të mëposhtme:

SYNERGY, Studimi “Ndërlidhjet energjetike në Europën Juglindore”.

PHARE, Studimi “CEECs – Siguria në shpërndarjen e gazit” – puna do të kryhet në kuadër të INOGATE.

CARDS 2001 studimi “Për infrastrukturën e naftës dhe të gazit”.

Do të merren në konsideratë gjithashtu edhe studimet e kryera nga vendet anëtare mbi tregun e energjisë dhe gazit në Ballkan.

Ndërtimi institucional në nivel bashkie për transportin dhe mjedisin

Tacis aktualisht po bashkëfinancon investimet në infrastrukturën bashkiake në dy qytete ukrainase dhe po planifikon një mekanizëm të ri bashkiak me BERZH-in në Rusi dhe në Ukrainë. Në Kroaci, programi CARDS për kthimin e refugjatëve i vitit 2001 dhe 2002 ka një komponent investimi bashkiak, ndërsa CARDS-2002 CSP për Kroacinë përfshin një projekt mbi rolet dhe përgjegjësitë bashkiake.

Programi rajonal i rindërtimit mjedisor (financuar me donatorë të KE-së dhe ato bilateralë) ka sjellë bashkë, Ministrat e Mjedisit të të gjitha vendeve të Ballkanit për t'u marrë vesh mbi prioritetet për investime dhe një plan-veprimi rajonal për mjedisin, financuar nga CARDS 2000 dhe 2002. Në vendet kandidate, zhvillimi i strategjisë financiare të investimeve për përshtatjen, financuar nga KE-ja dhe bashkëpunimi teknik me bashkitë ka rezultuar i domosdoshëm. Programi ISPA-së në vendet kandidate të Europës Qendrore dhe Lindore ka funksionuar në nivel bashkiak për të përmirësuar infrastrukturën e transportit dhe mjedisit; ai ofron grante nga 50% deri në 72% për projektet që arrijnë kriteret e nevojshme. BERZH-i ka bashkëfinancuar shumë nga këto projekte.

Mekanizmi i përgatitjes së projektit të rrjetit të energjisë

Ky projekt do të vazhdojë Projektin e CARDS 2001 për studimin rajonal të infrastrukturës së Ballkanit dhe do të zbatohet nën mbikëqyrjen e komitetit drejtues kryesuar nga KE-ja dhe përbërë nga institucionet financiare ndërkombëtare kryesore (BEI, BERZH, Banka Botërore) dhe nga institucionet e interesuara (Pakti i Stabilitetit, KE DG TREN).

Siguria në aviacion dhe kontrolli i trafikut ajror.

Koordinimi do të sigurohet me donatorë ndërkombëtarë dhe me programin që funksionon në mënyrë efektive me aviacionin civil në Bosnjë (Projekti i CARDS-it).

5. Përfundimet e nxjerra

Lidhjet ndërmjet programit dhe MIPC-it: programi aktual në çdo fushë projekti adreson lidhjen me objektivat e vendosura në materialin e strategjisë rajonale (Regional Strategy Paper RSP) dhe Programin indikativ shumëvjeçar (MIP).

Koncentrimi mbi një numër më të vogël sektorësh dhe aktiviteteve të identifikuar me RSP-në dhe adresimi i dobësive që ndikojnë mbi rajon.

Planifikimi afatmesëm: programi i vitit 2002 ka qenë planifikuar me perspektiva afatmesme paraqitur në MIP dhe është konsekuent me programet e vitit 2001.

Kohëzgjatja e projekteve: projektet e përfshira në programin e vitit 2002 mesatarisht do të kenë një kohëzgjatje më të gjatë se programet e mëparshme. Kjo duhet të sigurojë më tepër vazhdimësi në dhënie të asistencës, meqenëse ka më pak zgjatje të kontratës, të cilat shkaktojnë shkëputje.

Aspektet kushtëzuese: Programi indikativ shumëvjeçar ka kushte specifike për çdo fushë prioritare. Këto kushte do të zhvillohen më tej gjatë detajimit të projektit.

Vlerësimi i mbështetjes së mëparshme nga Komuniteti dhe donatorë të tjerë. Ky jep mësimet të vlefshme të cilat janë duke u përfshirë në hartimin e mbështetjes së ardhshme të CARDS-it rajonal.

Koordinimi: koordinimi rajonal duhet të sigurohet jo vetëm nga zyrtarët e Europaid në Bruksel, por gjithashtu nga delegacionet e Komisionit në Ballkan, duke organizuar rregullisht mbledhje në vende të ndryshme ndërmjet vendeve anëtare, autoriteteve kombëtare dhe organizatave të tjera të përfshira (si Institucionet Financiare Ndërkombëtare) për të siguruar programimin, monitorimin dhe koordinimin e përgjithshëm në vazhdimësi të të gjithë ciklit të programit.

6. Komponentet e Programit

Më poshtë, përshkruhen aktivitetet që do të mbështeten. Detaje të mëtejshme (duke përfshirë Log Frames) të projekteve individuale do të gjenden në setin e veçantë të anekseve. Këto fisha projekti nuk do të jenë pjesë e vendimit të komisionit.

Vërejtje: numrat e referencës për anekset e projekteve individuale korrespondojnë me ato të përdorura më poshtë.

Menaxhimi i integruar i kufijve

1.1. Zhvillimi i mëtejshëm dhe koordinimi i strategjive të menaxhimit të integruar të kufijve

Buxheti i Projektit: € 1.000.000 (±20%)

Projekti aktual do të sigurojë që mbështetja e CARDS-it për këtë sektor është zhvilluar dhe zbatuar duke ndjekur metodologjinë koherente rajonale dhe në një mënyrë të koordinuar në të gjithë rajonin e SAP-it. Në fund, ky Projekt do të fokusohet në mbështetjen për vendet, në mënyrë që këto të zhvillojnë strategji dhe programe kombëtare koherente të menaxhimit të integruar të kufijve dhe të sigurojnë lidhjen dhe përputhjen e tyre me ato të fqinjëve.

Objektivi i përgjithshëm i Programit të menaxhimit të integruar të kufijve është të arrijë një balancim ndërmjet nevojave për të lehtësuar lëvizjen e njerëzve dhe mallrave, dhe të ushtrojë një kontroll efektiv të kufijve për të mbrojtur publikun nga aktivitetet e paligjshme dhe të sigurojë sigurinë në rajon.

Objektivi specifik i këtij Projekti është të asistojë vendet e SAP-it për të siguruar që strategjitë e tyre kombëtare të menaxhimit të integruar të kufijve do të zhvillohen më tej dhe do të koordinohen efektivisht dhe në mënyrë plotësuese duke ndjekur një metodologji koherente rajonale.

Aktivitetet e financuara nën këtë program duhet të marrin në konsideratë rezultatet dhe rekomandimet e nxjerra nga misionet vlerësuese të JHA-së, financuar nga Programi rajonal CARDS i vitit 2001, i cili do të zbatohet para verës së vitit 2002

Ndërtimi institucional

2.1. Mekanizmi i ndërtimit institucional për SAP-in

2.2.1. Mekanizmi i mbështetjes së përgjithshme

Buxheti i Projektit: € 3.900.000 (±20%)

Objektivi i gjerë i mekanizmit të mbështetjes së përgjithshme (GSF) është të kontribuojë në

rritjen e kapaciteteve të administratave publike kombëtare në FYROM, Bosnjë-Hercegovinë, Shqipëri, Kroaci dhe RFJ-së duke përfshirë dhe Kosovën, për të ndërmarrë obligimet e tyre në kuadër të SAP-it dhe marrëveshjet e tij përbërëse.

GSF-ja është një komponent i një pakete shumë më të gjerë masash nga CARDS-i për të asistuar vendet në këtë zonë. GSF-ja, fillimisht ka si qëllim lehtësimin e efikasitetit dhe impaktit të programeve kombëtare të CARDS-it në ndërtimin institucional.

Objektivat specifike të GSF-së janë të ndihmojë vendet e SAP-it:

për të transmetuar, zbatuar dhe forcuar politikatat dhe legjislacionin që është përfshirë me acquis të BE-së në fusha kyçe që dalin nga SAP-i;

për të rritur ndërgjegjësimin për politikatat dhe legjislacionin e BE-së në fusha kyçe të SAP-it dhe në angazhime multilaterale, në veçanti në drejtim të OBT-së.

2.2.1. Çështje teknike të lidhura me tregtinë.

2.2.1. Të drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale

Buxheti: € 2.000.000 (±20%)

BE-ja është partneri më i rëndësishëm në tregti dhe burim i investimeve direkte të huaja. Integrimi rajonal është i një rëndësie të madhe për të kontribuar në stabilitetin e rajonit.

Të pesë vendet kanë pasur disa dobësi në qeverisje dhe zhvillim institucional. Në lidhje me politikën tregtare, një numër institucionesh kanë nevojë të forcohen, siç janë institucionet që kanë të bëjnë me të drejtën e pronësisë intelektuale dhe industriale.

Objektivi i gjerë i Projektit është të mbështesë zhvillimin ekonomik të pesë vendeve të CARDS-it nëpërmjet një mbrojtjeje efektive dhe adekuate dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale dhe intelektuale në përputhje me kërkesat e MSA-së dhe OBT-së.

Objektivat specifike të Projektit janë:

- adaptimi i kornizave ligjore kombëtare të TRIPS-it në të gjitha fushat e mbrojtjes së pronësisë intelektuale;

- siguri i një niveli të mbrojtjes së pronësisë industriale dhe intelektuale të ngjashëm me atë që ekziston në BE, për Shqipërinë, FYROM dhe Kroacinë dhe të sigurojë përputhjen me kërkesat e TRIPS-it për të gjitha vendet;

- forcimi i institucioneve të pronësisë intelektuale dhe autoriteteve zbatuese;

- përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe harmonizimi;

- ngritja e ndërgjegjësimit të përgjithshëm për pronësinë intelektuale.

Kontrata direkte: Kontrata duhet të konkludohet direkt dhe me Zyrën për Harmonizimin e Tregjeve të Brendshme (OHIM) dhe Zyrën Europiane të Patentave (EPO), meqenëse këto janë institucione unike në Europë dhe që merren respektivisht: OHIM me markat tregtare dhe disenjot industriale dhe EPO me markat. Nuk ekziston ndonjë institucion tjetër në nivel teknik në këtë fushë.

2.3. Infrastruktura e cilësisë

Buxheti: € 1.500.000 (±20%)

Secili nga pesë vendet ka në nivel kombëtar, projekte me qëllim përafrimin e legjislacionit dhe rregullave teknike për prodhimet industriale në "acquis" të BE-së. FYROM, Kroacia dhe Shqipëria do të fillojnë secila nga një projekt në kuadër të programit të veprimit 2001. Bosnjë-Hercegovina dhe RFJ-ja janë duke identifikuar projektet në këtë fushë.

Objektivat specifike të projektit:

- të merret një panoramë e sigurt dhe e krahasueshme në çdo vend të CARDS-it, mbi situatën e infrastrukturës së cilësisë dhe përmirësimet e nevojshme;

- rritja e njohurisë rreth/dhe ndërgjegjësimi për infrastrukturën e cilësisë ndërmjet autoriteteve publike, ndërmarrjeve dhe konsumatorëve;

- të rrisë numrin e ekspertëve teknikë të trajnuar në fusha të ndryshme të infrastrukturës së cilësisë dhe të krijojë rrjetet e ekspertëve;

- fillimi i bashkëpunimit të orientuar nga rezultati ndërmjet vendeve të CARDS-it për zhvillimin e infrastrukturës së tyre të cilësisë.

Kontrata direkte: Kontrata do të konkludohet me Komitetin Europian për standardizimin (CEN), meqenëse ka një rol paneuropian për nxitjen e harmonizimit teknik vullnetar. CEN, si një organizatë horizontale europiane e standardeve është në pozicion, që të sigurojë paanësi në lidhje me projektet e ardhshme të përbashkëta në Ballkan, që rezultojnë nga bashkëpunimi i inicuar nga ky Projekt, i cili mund të jetë i vlefshëm për financime të CARDS-it.

2.3. Politika rajonale dhe bashkëpunimi juridik: Drejtësia dhe çështjet e brendshme

2.3.1. Bashkëpunimi rajonal ndërmjet strukturave të zbatimit të ligjit në fushën e gjyqësorit dhe policisë

Buxheti: € 8.000.000 (±20%)

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është të ulë nivelin e aktiviteteve kriminale (duke përfshirë krimin e organizuar, kontrabandën, trafikimin e qenieve njerëzore dhe emigracionin ilegal) në vendet partnere, dhe në këtë mënyrë të rrisë sigurinë dhe rendin publik në këtë rajon fqinj me Bashkimin Europian.

Objektivat specifike të këtij Projekti janë: forcimi i shërbimit të policisë kombëtare dhe shërbimeve të tjera të zbatimit të ligjit, gjyqësorit (duke përfshirë prokurorinë, sistemin e burgjeve dhe profesionet ligjore në përgjithësi) dhe autoriteteve kombëtare të emigracionit dhe të përmirësojë efektivitetin e tyre për të luftuar krimin kombëtar dhe ndërkombëtar duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore dhe emigracionin ilegal.

Partnerët kryesorë të Projektit do të jenë shërbimet e ndryshme të policisë, prokuroritë dhe gjykata, si dhe agjenci të tjera të përfshira në aktivitetet e përcaktuara në 5 (pesë) vendet partnere.

Interpoli (OIPC) do të jetë partneri zbatues për aktivitetet në lidhje me rritjen e kapacitetit të Byrosë Kombëtare të Kontaktit për Interpolin në të 5 (pesë) vendet.

Së fundi, partnerët specifikë të projektit do të përzgjidhen për trajnimin e përcaktuar (mundësisht Cepol, Europol, Këshilli i Europës ose organizata të tjera relevante), gjithashtu dhe për zbatimin e aktiviteteve të lidhura me azilin dhe emigracionin, duke marrë plotësisht në konsideratë nevojën për koordinimin me organizata të tjera ndërkombëtare që janë aktive në këtë fushë.

Aktivitetet e financuara në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme do të duhet të marrin parasysh, në qoftë se është e nevojshme, edhe rezultatet e misionit të vlerësimit të JHA-së të Komisionit Europian dhe ekspertëve të shteteve anëtare.

Zhvillimi i procedurave të azilit dhe kërkesave për vizë që janë koherente ndërmjet 5 (pesë) vendeve dhe "acquis" të BE-së, do të kërkojë koordinim dhe mbështetje në nivel rajonal dhe do të përcaktohet nga rekomandimet e raporteve të misioneve të vlerësimit të vitit 2001.

2.4. Rrjetet europiane për zhvillime të qëndrueshme

2.4.1. Vazhdimi i aktiviteteve mbështetëse në programin e rindërtimit mjedisor rajonal

Buxheti: € 2.000.000

Ky Projekt do të ndihmojë vendet e Europës Juglindore për të zhvilluar institucionet administrative për të qenë në gjendje të sigurojnë mbrojtjen e mjedisit me standardet e praktikuar brenda BE-së. Ajo do të ndihmojë bashkëpunimin mjedisor rajonal, që të jetë në një linjë me qëllimet e procesit të Stabilizim Asocimit.

Objektivat specifike të këtij Projekti janë:

- të mbështesë bashkëpunimin rajonal përmes Programit të rindërtimit mjedisor rajonal për 2 (dy) vite të mëtejshme;
- të forcojë kapacitetet e agjencive mjedisore kombëtare përmes mbështetjes në përqasjen me rrjetin mjedisor në Ballkan dhe forcimin e rrjetit;
- të bëjë të mundur prioritetet e programeve investuese mjedisore;
- të rrisë kapacitetet administrative mjedisore në vlerësimin e impaktit mjedisor dhe vlerësimin mjedisor strategjik, ekspertizës financiare dhe hartimit të ligjeve.

Ky Projekt do të realizohet nga Qendra Mjedisore Rajonale (REC) për të siguruar vazhdimësinë me fazën e mëparshme.

Projekti do të fillojë me kompletimin e fazës së mëparshme (gusht 2003). Rezultatet do të shpërndahen në të gjithë rajonin.

2.4.2. Forcimi i kapaciteteve në vendet e Ballkanit në raportimin mjedisor dhe zhvillimin e rrjetit EIONET

Buxheti: € 2.000.000

Objektivi i Projektit është të forcojë bashkëpunimin e Agjencisë Mjedisore Europiane me Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Kroacinë, Republikën Federale të Jugosllavisë dhe FYROM-in, për të kontribuar në një integrim të suksesshëm të këtyre 5 (pesë) vendeve ballkanike në programin e punës së Agjencisë Mjedisore Europiane, dhe përgatitjen e mëtejshme të bazave për anëtarësimin e ardhshëm në Agjencinë Mjedisore Europiane.

Projekti aktual synon të ndihmojë Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Kroacinë, Republikën

Federale të Jugosllavisë dhe FYROM-in, në vazhdimësinë e bashkëpunimit me Agjencinë Mjedisore Europiane e cila do të krijohet dhe zhvillohet në vitet 2001/2002.

Objektivi specifik është që të sjellë 5 (pesë) vendet në një qark raportimi të rregullt në Agjencinë Mjedisore Europiane dhe t'i bashkëngjisin rrjetet e tyre të informacionit mjedisor kombëtar në EIONET. Të 5 (pesë) vendet janë tashmë të lidhura me "data bases" të përdorura nga EEA-ja, por akoma nevojitet shkëmbimi i informacionit dhe sigurimi i vazhdueshmërisë së veprimit me njëri-tjetrin dhe me vendet anëtare të EEA-së.

Është e rëndësishme të vazhdojë dhe të forcohet bashkëpunimi i Agjencisë Mjedisore Europiane me këto vende në një mënyrë uniforme me qëllim që të ecet mbi rezultate që janë arritur tashmë.

Projekti do të realizohet në Agjencinë Mjedisore Europiane, Kopenhagen dhe në 5 (pesë) vendet e Ballkanit.

Stabilizimi demokratik

3.1. Stabilizimi demokratik

Projektbuxheti: € 7.600.000 (±20%)

Objektivi më i gjerë është të ndihmojë vendet e SAP-it në arritjen e demokracive të qëndrueshme dhe në zgjerimin e niveleve të tyre për aktivitetet e shoqërisë civile.

Objektivi specifik është të ndihmojë shoqërinë civile dhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare, që merren me problemet në nivel rajonal, në lidhje me: proceset emergjente demokratike, median e pavarur, të drejtat e minoriteteve, rikthimin e refugjatëve, zhvillimin e qëndrueshëm dhe krimin ndërkufitar, veçanërisht trafikimin e qenieve njerëzore.

Misioni i vlerësimit të ekspertëve të CARDS-it mbi drejtësinë dhe çështjet e brendshme në shtetet e Ballkanit Perëndimor, i cili do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me shtetet anëtare të BE-së, do të formulojë rekomandimet të cilat do të përdoren për të zhvilluar një drejtim strategjik për zbatimin e projekteve të antitrafikut, antikorrupsionit dhe kthimit të refugjatëve (të drejtat e pronësisë). Këto misione do të ndiqen, kur është e nevojshme, ose në dialog specifik me vendet në fjalë, ose me vlerësime të mëtejshme specifike apo në forma të tjera që mund të nevojiten.

Efektiviteti i këtij komponenti do të rritet më tej dhe do të plotësojë bashkëpunimin rajonal ndërmjet strukturave gjyqësore dhe policore, si dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit sipas këtij program-veprimi.

Koordinimi është në mënyrë të veçantë i rëndësishëm në nxitjen e mediave të lira dhe të pavarura, sepse janë 3 (tre) instrumente të Komunitetit që operojnë (CARDS-i kombëtar, rajonal dhe EIDHR) gjithashtu, dhe për mbështetjen substanciale nga shtetet e tjera anëtare të komunitetit ndërkombëtar.

Kontratat direkte: Për pjesën e cila përbën interes për zhvillimin e qëndrueshëm, do të konkludohet një marrëveshje direkte me Qendrën Mjedisore Rajonale.

Projekti do të menaxhohet nga REC nën ombrellën e REREP-it dhe do të koordinohet me programet e tyre grant, që janë në vazhdimësi në rajon.

Fakti që mekanizmat e REREP-it, ndihmojnë për të koordinuar aktivitetet e donatorëve në fushën e zhvillimit mjedisor do të sigurojë që mbështetja në zhvillimin e OJQ-ve në këtë fushë do të koordinohet me kontributet e tjera kyç në këtë fushë.

Për pjesën në lidhje me kthimin e refugjatëve, ekspertët do të rekrutohen për të bërë një analizë paraprake të plotë. Në një fazë të dytë do të duhet të identifikohet një organizatë ndërkombëtare e pranueshme, me të cilën do të duhet të nënshkruhet një marrëveshje direkte. Në qoftë se nuk do të mund të identifikohet asnjë organizatë ndërkombëtare, atëherë do të duhet të lançohet një tender ose kërkesë për propozim për zbatimin e këtyre aktivitetëve.

4. Infrastruktura rajonale

4.1. Zhvillimi i infrastrukturës rajonale

4.1.1. Mbështetje për investimin mjedisor në basenin e lumit Danub

Buxheti: Euro 4.000.000 (±20%).

Objektivi më i gjerë i Projektit është të inkurajojë dhe të shpejtojë investimet, në investimet

mjedisore ndërkufitare, për të lehtësuar kushtet e jetesës dhe të reduktojë ndotjen mjedisore në vendet e Ballkanit, me një fokus të veçantë në, por jo e kufizuar tek problemet e ujit të lidhura me basenin e lumit Danub.

Objektivat specifike të Projektit janë:

- të përdorë fondet e CARDS-it për të nxitur mbështetjen e IFI-së dhe për të lehtësuar projektet financuese në rajon;

- të lehtësojë bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet insitucioneve financuese ndërkombëtare dhe CARDS-it, në identifikimin dhe përgatitjen e projekteve investuese mjedisore për financimin e IFI-së.

- të realizojë fizibilitetin dhe studime të tjera relevante mbi projektet e përzgjedhura;

- të transferojë “know how” në zhvillimin e projektit dhe paketës financuese në rajon.

4.1.2. Zhvillimi dhe zbatimi i një plan-veprimi për tregun e gazit natyror rajonal në Europën Juglindore

Buxheti: Euro 1.800.000 ($\pm 20\%$).

Objektivi i Projektit është të krijojë bazat ligjore dhe rregullat për një funksionim të mirë të tregut të gazit natyror, për të kontribuar në një integrim të suksesshëm të këtyre vendeve në tregun e brendshëm të Bashkimit Europian të gazit.

Objektivat e projektit janë:

- të krijojë bazat ligjore për një treg rajonal të gazit, duke përfshirë një program indikativ për të harmonizuar legjislacinin në këtë fushë. Sistemet ekzistuese të tarifave në nivel kombëtar do të duhej të ekzaminoheshin;

- të krijojë një Komitet Rajonal të Tregut të Gazit.

4.1.3. Lehtësitë financiare lokale për transportin dhe mjedisin

Buxheti: Euro 1.700.000 ($\pm 20\%$).

Ky Projekt është hartuar për të ndihmuar bashkitë e vogla në rindërtimin e tyre dhe investimet infrastrukturore në të gjithë shërbimet bashkiake, nëpërmjet trajnimit të stafit në bashkitë dhe sektorët bankarë lokalë, për të përdorur dhe menaxhuar burimet e vlefshme për këto detyra.

Ky Projekt do të jetë pilot për mbështetje të mëtejshme në vendet e tjera ballkanike në vitet 2004-2005. Ai do të fokusohet në vitet 2002-2003 në Kroaci dhe Serbi.

Projekti do të fokusohet në forcimin e strukturës organizative dhe financiare të shërbimeve publike lokale dhe qyteteve në Ballkan. Vetë huatë e EBRD-së do të financojnë zhvillimin e infrastrukturës prioritarë në ujëra, në kanalizime, në transport urban, në mbetje të ngurta dhe në ngrohje lokale. Bashkitë do të bashkëfinancojnë, në qoftë se është e mundur, me fondet e tyre.

Tetë (8) bashki janë tashmë të identifikuar në Kroaci dhe Serbi për hua të vogla specifike.

EBRD-ja do të menaxhojë Projektin përmes një marrëveshje direkte. Ata do të jenë përgjegjës për zhvillimin e kriterëve për aplikantët dhe për huatë. BE-ja do të jetë pjesëmarrëse në komitetin drejtues për të supervizuar projektin.

4.1.4. Lehtësitë e përgatitjes së Projektit të rrjeteve të energjisë

Projektbuxheti: Euro 1.500.000 ($\pm 20\%$).

Ky Projekt synon në tërheqjen e investimeve për zhvillimin e një rrjeti koherent për naftën, gazin dhe infrastrukturën e energjisë në rajonin e Europës Juglindore. Kjo është arritur nëpërmjet përgatitjes së fizibilitetit dhe studimeve parainvestuese dhe, kur është pozitive, dokumentet për tenderimin e punimeve ndërtuese. Prioritet do t'u jepet elementeve shkëputës të zinxhirit rajonal.

Ky Projekt do të ndjekë Programin e infrastrukturës ballkanike rajonale prej euro 2.1. milion për elektricitetin dhe për rrjetin e naftës dhe të gazit (respektivisht Euro 2.1. milionë dhe Euro 0.7 milionë nga CARDS-i rajonal i vitit 2001).

Aktivitetet e këtij Projekti do të ndërmerren në bashkëpunim të ngushtë me institucionet lokale përkatëse, për të siguruar konsolidimin dhe rritjen e tyre.

4.2. Siguria në aviacion dhe kontrolli i trafikut ajror

Projektbuxheti: Euro 5.000.000 ($\pm 20\%$)

Objektivi më i gjerë i Programit është krijimi i një autoriteti efektiv dhe eficient i aviacionit civil (CAA) në secilën nga 5 (pesë) vendet e CARDS-it, për të qenë të aftë në plotësimin e përgjegjësisë ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare në çështjet e aviacionit civil.

Objektivi specifik: Për ta sjellë sigurinë dhe kontrollin e trafikut ajror sipas standardeve të Europës Perëndimore.

Asistenca teknike për forcimin e kapaciteteve do të mund të përfshinte si më poshtë:

- identifikimin, vlerësimin dhe rishikimin e arritjeve të autoriteteve dhe institucioneve përkatëse në fushën e menaxhimit të trafikut ajror, kontrollit dhe regjimit rregullator të tyre në 5 (pesë) vendet e CARDS-it;

- vlerësimin e nevojave të institucioneve përkatëse në aspektin e menaxhimit të kapaciteteve teknike, për të dhënë udhëzime dhe ekspertizë, me qëllim që të arrihet zbatimi efektiv i politikave dhe instrumenteve rregullues në drejtim të standardeve përkatëse;

- ndihmën për krijimin e rrjeteve rajonale të institucioneve përkatëse me qëllimin e rënies dakord mbi standardet dhe teknologjitë, dhe organizimin e aktiviteteve shkëmbyese në të 5 (pesë) vendet e CARDS-it;

- ndihmën në zhvillimin e strategjive kombëtare mbi navigimin ajror, për të hartuar planet e punës kombëtare për përmirësimin e kontrollit të trafikut ajror dhe sigurisë ajrore me një metodologji në përputhje me standardet përkatëse, për të bërë trajnimin e stafit të institucioneve në fjalë dhe për të ngritur ndërgjegjësimin e rekrutimit të stafit të kualifikuar;

- propozimin për veprime të mëtejshme mbi zbatimin dhe koordinimin e axhendës së zbatimit me donatorë të tjerë ndërkombëtarë, në veçanti EIB dhe EBRD.

Ndërsa programi CARDS mund të krijojë prekuizitat institucionale për investime, këto të fundit do të nevojiten të ndërmerren nga shtetet ose kompanitë.

Komisioni mund të zbatojë detyrat, të cilat janë kompetencë e eurokontrollit përmes një marrëveshjeje direkte me këtë institucion. Në këtë aspekt, një protokoll është negociuar ndërmjet Komisionit dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Transport dhe Energji, duke vendosur kritere për punë të përbashkët. Marrëveshja direkte e përmendur më sipër do të duhej të jetë në një linjë me këtë protokoll.

Balanca ekzakte ndërmjet komponentit të trafikut ajror dhe komponentit të sigurisë ajrore të këtij Projekti do të identifikohen në fazën e termave të referencës përmes një misioni ad-hoc në secilin nga vendet.

7. Zbatimi i Programit

Ky Program rajonal do të zbatohet i centralizuar nga Zyra e Bashkëpunimit për Ndihmën Europiane (AIDCO), në emër dhe në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet përkatëse, agjencitë ndërkombëtare dhe donatorët, të cilët janë aktivë në fusha të ndryshme të Programit.

8. Monitorimi, vlerësimi dhe kontrolli

Ky Program do të monitorohet dhe supervizohet nga shërbimet e Komisionit Europian, që:

a) do të monitorojë zbatimin e programit mbi bazën e raporteve të rregullta, kontakteve me sipërmarrësit dhe vizitave në terren;

b) do të realizojë monitorim dhe vlerësim të rregullt për të ndjekur progresin e programit dhe komponentët e tij, si dhe vlerësimin e ex-post pas përfundimit të tij.

Llogaritë dhe veprimet e komponentëve të Programit do të kontrollohen me intervale nga një kontrollues i jashtëm i kontaktuar nga Komisioni pa paragjykuar përgjegjësitë e Komisionit Europian, duke përfshirë Zyrën Europiane Antievasion (OLAF) dhe Gjykatën e Auditimit të Bashkimit Europian.

9. Procedurat e tenderimit

Kontratat për shërbimet, punimet dhe furnizimet do të konkludohen në përputhje me procedurat e tenderimit dhe kontratave të përcaktuara në rregulloren financiare, Rregulloren e Këshillit 2666/200 amenduar me Rregulloren e Këshillit (EC) nr.2415/2001 të datës 10 dhjetor 2001 dhe "Manuali i instruksioneve për kontratat e konkluduara për qëllim të bashkëpunimit të Komunitetit me vendet e treta" (adaptuar prej Komisionit në 10 nëntor 1999).

Për disa nga projektet janë parashikuar kontrata direkte, siç thuhet në pikën 6 të këtij Programi.

10. Kostoja dhe financimi

Programet do të financohen nëpërmjet një granti nga komuniteti me vlerë 43.3 milion, i shpërndarë si më poshtë:

- | | | |
|----|--|-------------|
| 1. | MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIJVE | |
| | Zhvillimi i mëtejshëm dhe koordinimi i strategjive | € 1.000.000 |
| 2. | NDËRTIMI I INSTITUCIONEVE | |

2.1.	Përgatitja e institucioneve për MSA-në	
2.1.1	Mbështetje e përgjithshme	€ 3.900.000
2.2.	Detyra teknike lidhur me tregtinë	
2.2.1.	E drejta e pronësisë industriale dhe intelektuale	
2.2.2.	Infrastruktura e cilësisë	
2.3.	Bashkëpunimi rajonal në polici dhe gjyqësor: Drejtësia dhe çështjet e brendshme	
2.3.1.	Bashkëpunimi rajonal midis gjyqësorit, policisë dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit	€ 8.000.000
2.4.	Rrjetet europiane për zhvillim të qëndrueshëm	
2.4.1.	Vazhdimësia e mbështetjes së aktiviteteve të Programit rajonal për rindërtim mjedisor	€ 2.000.000
2.4.2.	Forcimi i kapaciteteve të vendeve të Ballkanit për raportimin mjedisor dhe zhvillimin e rrjetit EIONET	€ 2.000.000
3.	STABILITETI DEMOKRATIK	
3.1.	Stabiliteti demokratik	€ 7.600.000
4.	INFRASTRUKTURA RAJONALE	
4.1.	Zhvillimi i infrastrukturës europiane	
4.1.1.	Mbështetje për investimet mjedisore në pellgun e lumit Danub	€ 4.000.000
4.1.2.	Zhvillimi dhe zbatimi i një plani veprimi për tregun rajonal të gazit natyror në Europën Juglindore	€ 1.800.000
4.1.3.	Zhvillimi i sektorit finciar bashkiak: Mjetet financiare bashkiake për transportin e mjedisin	€ 1.700.000
4.1.4.	Mjetet e përgatitjes së Projektit të rrjeteve energjitike	€ 1.500.000
4.2.	Kontrolli i trafikut ajror: Ndërtimi institucional	
	Siguria në aviacion dhe kontrolli i trafikut ajror	€ 1.500.000
5.	Të tjera	
5.1.	Rezerva	€ 1.500.000
	Totali	€ 43.500.000

11. Detyrimet e qeverisë. Kushtëzimet

Asistenca është akorduar mbi bazën e ekzistencës së elementeve të nevojshme për vazhdimin e bashkëpunimit nëpërmjet asistencës, duke respektuar veçanërisht principet e demokracisë dhe të drejtat e njeriut, si dhe obligimet e vendeve përfituese siç edhe theksohet në Marrëveshjet e Partneritetit dhe Bashkëpunimit/Procesi/Marrëveshjet e Stabilizim Asocimit. Kushtëzime specifike për zbatim mund të jepen për disa projekte të veçanta.

12. Tabela analitike e disbursimeve(milion E)

	Qershor 2002	Dhjetor 2002	Qershor 2003	Dhjetor 2003	Qershor 004	Dhjetor 2004	Qershor 2005	Dhjetor 2005
Zhvillimi i mëtejshëm dhe koordinimi i strategjive të menaxhimit të integruar të kufijve		0.30	0.60	0.60	0.80	1.00	1.00	1.00
Mjetet e përgjithshme për mbështetje		0.90	1,40	1.90	2.40	2.90	3.40	3.90
Pronësia industriale dhe intelektuale			0.50	0.50	1.40	1.40	2.00	2.00
Cilësia e infrastrukturës			0.375	0.375	1.05	1.05	1.50	1.50
Bashkëpunimi rajonal nëpërmjet gjyqësorit, policisë dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit				1.00	3.00	5.00	7.00	8.00

Vazhdimësia në mbështetje të aktiviteteve të Programit të rindërtimit rajonal të mjedisit		0,60	0.60	0.80	0.80	0.90	1.00	2.00
Forcimi i kapaciteteve në vendet ballkanike në kuadër të raportimit mjedisor dhe zhvillimit të rrjetit EIONET		0.80	0.80	0.80	1.20	1.20	1.20	2.000
Stabiliteti demokratik			2.75	2.95	4.84	5.00	7.10	7.60
Mbështetja për investime me qëllim ruajtjen e mjedisit në pellgun e Danubit			1.20	1.60	1.80	2.00	3.00	4.00
Zhvillimi dhe zbatimi i një plani veprimi për tregun rajonal të gazit natyror në zonën e Europës Juglindore			0.50	1.00	1.50	1.80	1.80	1.80
Mjetet financiare të bashkive për transportin dhe mjedisin		0.50	0.50	0.50	0.50	1.02	1.02	1.70
Projekti i rrjetit energjetik. Faza përgatitore			0.50	1.00	1.50	1.50	1.50	1.50
Siguria në aviacion dhe kontrolli i trafikut ajror			1.50	2.40	3.30	4.20	5.00	5.00
Fonde rezervë								1.50
Totali	0	3.1	11.225	15.425	24.09	28.97	36.52	43.5

ANEKSI A: Gjendja e asistencës rajonale në datë 29 prill 2002 në 1000 E për projekt

2000	Reforma në administratën publike – faza I 950					
2001						
Viti	Projekti	Angazhuar	Kontraktuar	Kontraktuar/ Angazhuar	Paguar	Paguar/ Angazhuar
	Drejtësia dhe çështjet e brendshme					
	Raportimi i situatës	1,500	1498.656	0%	00	0%
	Bashkëpunimi i policisë rajonale	1,400	00	0%	00	0%
	Drejtësia rajonale dhe trajnimi i policisë	1,300	0		0	
	Infrastruktura					
	Përgatitja e projekteve të infrastrukturës	3,000	0		0	
	Forcimi i administratës publike					
	Reforma në administratën Publike – faza II	2,850	2850		0	
	Statistikat Rajonale –	2,500	00	0%	00	0%

	Programi Eurostat					
	Bashkëpunimi me Agjencinë Europiane të Mjedisit	500	5000	0%	00	0%
	Stabiliteti demokratik					
	Media	300	300		0	
	Rrjeti universitar rajonal	500	500		0	
	Totali 2001	14,000	5648.656	400%	0	0%

ANEKSI B: ASISTENCA E KOMISIONIT EUROPIAN PËR VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR
NË PERIUDHËN 1991-2001

Angazhimet në milion euro

Vendi	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
SHQIPËRIA											
Phare/Cards	10,00	75,00	40,00	49,00	53,00	53,00	70,40	42,50	99,90	35,45	37,50
Demokracia dhe të drejtat e njeriut					1,00	0,60	0,40	0,80	0,17	0,52	0,40
Veprime specifike									2,60	1,92	
Ndihma humanitare		4,13			1,15	1,65	16,30	11,00	97,07	3,40	6,60
FEOGA		120,00									
Sigurimi i ushqimit							10,80		5,50		
Ndihma në makroekonomi (1)		70,00			15,00	20,00					
Totali		368,13			70,15	75,25	97,90	54,30	205,24	41,29	44,50
BOSNJË-HERZEGOVINA											
Phare/Obnova/Cards				0,21	0,65	229,77	211,16	190,50	118,36	100,85	105,23
Demokracia dhe të drejtat e njeriut					0,70	4,80	4,80	1,80	0,79	0,62	0,80
Veprime specifike					70,00	65,40	39,90	15,00	30,90	3,96	
Ndihma humanitare		495,26			145,03	142,45	105,00	87,95	58,90	0,40	0,75
Ndihma në makroekonomi (1)									25,00	10,00	25,00
Totali		495,47			216,38	442,42	360,86	295,25	233,95	115,83	131,78
KROACIA											
Obnova/Cards				0,09	0,31	11,71	10,26	15,59	11,50	18,34	60,00
Demokracia dhe të drejtat e njeriut						0,70	2,20	0,60	0,21	0,97	0,50
Veprime								1,00	0,42	0,31	0,98

[illegible]

reaksionit të shpejtë											
Ndihma në makroekonomi (1)						25.00	15		20.00	10.00	
Totali		101.52			34.43	25.00	58.71	40.48	108.61	47.07	85.75
Rajoni											
Phare/Obnova/Cards		81.44			0.61	0.15	1.45	8.40	2.20	18.75	20.00
Demokracia dhe të drejtat e njeriut							5.30	0.90	6.40	7.36	3.68
Specifikime										2.71	
Ndihma humanitare		17.10			20.00			17.00	39.32	1.08	1.00
Totali		98.54			20.61	0.15	6.75	26.30	47.92	29.90	24.68
Grand totali		1.439.14			420.26	600.48	569.48	477.71	998.36	1.052.42	1.247.46

1. Ndihma në makroekonomi i referohet disbursimeve dhe përfshin si grantet ashtu edhe kreditë.

2. Të dhënat në vitin 2001 i referohen Jugosllavisë si të tërë.

3. Duke përfshirë ndihmën emergjente CARDS me total Euro 13.7 milionë në vitin 2001.

L I G J
Nr.9002, datë 6.2.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETIT EUROPIAN, NË KUADËR TË PROGRAMIT “CARDS 2002”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Europian, në kuadër të Programit “CARDS 2002”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3716, datë 28.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

MARRËVESHJE FINANCIARE

Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtej e tutje referuar si “Komisioni” duke vepruar për/dhe në emër të Komunitetit Europian, këtej e tutje referuar si “Komuniteti” nga njëra anë dhe Qeveria e Shqipërisë, këtej e tutje referuar si “Përfituesi”, nga ana tjetër,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Masa referuar artikullit 1 më poshtë do të ekzekutohet dhe financohet nga buxheti i Komunitetit në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Marrëveshje. Kuadri teknik, ligjor dhe administrativ brenda të cilit Masa, referuar artikullit 1 më poshtë do të zbatohet, është përcaktuar në kushtet e përgjithshme në aneksin A të Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit, dhe amenduar e plotësuar nga kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe dispozitave të veçanta bashkëngjitur kësaj.

Neni 1

Natyra dhe subjekti

Si një pjesë e programit të tij të ndihmës, Komuniteti do të kontribuojë, në formë granti, në drejtim të financimit të Masës së mëposhtme:

Titulli: Programi mbështetës për Shqipërinë në 2002

Vlera: Euro 44,9 milion

Datat e përfundimit: 31.12.2005 për kontraktim, 31.12.2006 për disbursim.

Neni 2

Angazhimi i Komunitetit

Kontributi financiar i Komunitetit është fiksuar në një maksimum prej 44.9 milion € këtej e tutje referuar si “Granti i KE-së”.

Granti i KE-së është subjekt i një afati mbarimi, 31.12.2005. Komisioni mund megjithatë, që në varësi të rrethanave, të bjerë dakord për një zgjatje të përshtatshme të këtij afati skadence, në qoftë se një zgjatje e tillë kërkohet dhe justifikohet në mënyrë të saktë nga Përfituesi.

Neni 3

Adresat

Korrespondenca në lidhje me ekzekutimin e masës, duke deklaruar numrin dhe titullin e masës, do të adresohet si më poshtë:

Për Komisionin	Për Përfituesin
Për Mr. Brix Knudsen	Z. Sokol Nako
Komisioni i Komuniteteve Europiane	Ministër i Shtetit për Integrimin
Zyra Europiane e Ndihmës dhe Europian	Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Bashkëpunimit	Tiranë, Shqipëri
Rue de la Loi 200	Fax: 355 4 234 818
B-1049 Brussels, Belgium,	
Adresa telegrafike: Comeur Bruxelles	
Telex: 21877 Comeu B	
Fax: 32-2 296 74 82	

Neni 4

Numri i kopjeve

Kjo Marrëveshje është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën, në të cilën ajo do të jetë nënshkruar nga të dyja Palët. Çdo shpenzim që kryhet nga kjo datë i përmbush kushtet e Grantit të KE-së.

Anekset do të konsiderohen si një pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Anekset:

A. Kushtet e përgjithshme në lidhje me Marrëveshjet Financiare

B. Arbitrazhi

C. Përshkrimi i Masës

Deklaratë: Lidhur me nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje Financiare do të hyjë në fuqi në datën e ratifikimit nga Parlamenti Shqiptar.

Vërtetohet se teksti në shqip i Marrëveshjes është i njëjtë me origjinalin.

DREJTORE
Valbona Kuko

ANEKSI A

KUSHTET E PËRGJITHSHME NË LIDHJE ME MARRËVESHJET FINANCIARE

Në këto kushte të përgjithshme termi “Përfituesi” do të nënkuptohet se i referohet Qeverisë Shqiptare.

KAPITULLI I
FINANCIMI I PROJEKTEVE

Neni 11
Angazhimi i Komunitetit

Angazhimi i Komunitetit, këtej e tutje referuar si “Granti i KE-së”, vlera e të cilit është përcaktuar në Marrëveshjen Financiare, do të vendosë kufirin brenda të cilit detyrimi dhe ekzekutimi i pagesave do të realizohet përmes kontratave dhe vlerësimeve, të aprovuara në përputhje me rregullat.

Çdo shpenzim përtej Grantit të KE-së do të përballohet nga Përfituesi.

Neni 2
Vlefshmëria e Grantit të Ke-së

Kur ekzekutimi i Masës varet nga detyrimet financiare nga burimet e veta të përfituesit ose nga burime të tjera fondesh, Granti i KE-së do të bëhet i mundshëm në një kohë të tillë që detyrimet financiare të Përfituesit dhe/ose burimet e tjera të fondeve, siç janë përcaktuar në Marrëveshjen Financiare, përmbushen.

Neni 3
Disbursimi

Kontratat janë të vlefshme për disbursime, sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, vetëm në qoftë se janë konkluduar përpara afatit të skadencës së Marrëveshjes Financiare. Disbursimet e këtyre kontratave mund të bëhen në një periudhë maksimum prej 12 muajsh pas afatit të skadencës së Marrëveshjes Financiare.

KAPITULLI II
DHËNIA E LEHTËSIRAVE

Neni 4

Privilegjet e përgjithshme

Personelit pjesëmarrës në masat e financuara nga Komuniteti, dhe anëtarëve të familjes së tyre mund t'u akordohen përfitime, privilegje dhe përjashtime jo më pak të favorshme, se ato që u akordohen zakonisht të huajve të tjerë të punësuar në shtetin e Përfituesit, sipas çdo marrëveshjeje tjetër bilaterale ose multilaterale për asistencë ekonomike dhe programeve të bashkëpunimit teknik.

Neni 5

Vendosja, instalimi, hyrja dhe lehtësirat e qëndrimit

Në rast të kontratave të punimeve, furnizimit ose shërbimeve, personave fizikë ose juridikë, pjesëmarrës në procedurat e tenderimit, do t'u jepet e drejta që përkohësisht të vendosen dhe të qëndrojnë kur rëndësia e kontratës e kërkon një gjë të tillë. Kjo e drejtë do të jepet vetëm pasi ftesa për tender është publikuar dhe do të përfitohet nga stafi teknik me nevojën për të kryer studime përgatitore në hartimin e tenderave. Kjo e drejtë do të përfundojë një muaj pas përcaktimit të kontraktorit.

Përfituesi do të lejojë personelin pjesëmarrës në kontratat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve financiar nga Komuniteti, dhe anëtarët e familjes së tyre, të hyjnë në shtetin e Përfituesit, të vendosen në këtë shtet, të punojnë atje dhe të largohen nga shteti në fjalë, në rast se natyra e kontratës e justifikon një gjë të tillë.

Neni 6

Importi dhe rieksperti i pajisjeve

Përfituesi do të japë të gjitha lejet e nevojshme për importimin e pajisjeve profesionale të kërkuara për realizimin e Masës, subjekt i ligjeve, rregullave dhe rregulloreve ekzistuese të Përfituesit.

Përfituesi do t'u japë më tej personave fizikë dhe juridikë, që kanë realizuar kontratat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve, lejet e kërkuara për riekspertimin e pajisjeve në fjalë.

Neni 7

Importet dhe shkëmbimi i kontrollit

Për realizimin e Masës, Përfituesi merr përsipër të japë autorizime importi dhe autorizime për përfitimin e shkëmbimit valutor dhe të zbatojë rregullat e kontrollit të shkëmbimit valutor kombëtar, pa diskriminim ndërmjet Shteteve Anëtare të Komunitetit dhe Shteteve Përfituese sipas rregullores OBNOVA, rregullores CARDS, vendet kandidate për anëtarësim në Bashkimin Europian dhe, në rastin kur Komisioni ka autorizuar pjesëmarrjen në ftesat për tender dhe kontrata, vendet përfituese sipas programit TACIS dhe MEDA gjithashtu dhe vendet e tjera.

Përfituesi do të japë lejet e nevojshme, të rikthejë fondet e marra në lidhje me Masën, në përputhje me rregulloret e kontrollit të shkëmbimit valutor në fuqi në shtetin e Përfituesit.

Neni 8

Taksat dhe doganat

1. Taksat, doganat dhe detyrimet e importit nuk do të financohen nga Granti i KE-së.

2. Importet, sipas kontratave të furnizimit të konkluduara nga autoritetet e përfituesit dhe financiar nga Granti i KE-së, do të lejohen të hyjnë në shtetin e Përfituesit pa qenë subjekt i detyrimeve doganore, detyrimeve të importit, taksave ose tarifave fiskale që kanë efekt të njëjtë.

3. Përfituesi do të sigurojë që importet në fjalë do të lejohen nga pika e hyrjes për t'u shpërndarë tek kontraktorët, siç kërkohet nga dispozitat e kontratës dhe për përdorim të menjëhershëm, siç kërkohet për një zbatim normal të kontratës, pavarësisht nga ndonjë vonesë ose konflikt mbi zgjidhjen e detyrimeve të përmendura më sipër, taksave ose tarifave.

4. Kontratat për furnizime ose shërbime të zbatuara nga firmat shqiptare ose të huaja, të financuara nga Granti i KE-së, nuk do të jenë subjekt në shtetin e përfituesit të taksës mbi vlerën e shtuar, vulës dokumentuese, detyrimeve të regjistrimit ose tarifave fiskale që kanë efekt të njëjtë,

pavarësisht nëse tarifa të tilla ekzistojnë apo që do të institucionalizohen.

5. Personat fizikë dhe juridikë, duke përfshirë stafin e huaj, nga vendet anëtare të Komunitetit Europian, që realizojnë kontratat e bashkëpunimit teknik financiar nga Granti i KE-së, do të përjashtohen nga taksa e aktivitetit dhe të ardhurave në shtetin e Përfituesit.

6. Mallrat personale dhe të familjes, të importuara për përdorim personal nga personat fizikë (dhe anëtarët e familjeve të tyre), përveç atyre të marra brenda vendit, të përfshirë në realizimin e detyrave të përcaktuara në kontratat e bashkëpunimit teknik, do të përjashtohen nga detyrimet doganore, detyrimet e importit, taksave dhe tarifave të tjera fiskale që kanë efekt të njëjtë. Mallrat personale dhe të familjes në fjalë do të rieksporthen ose do të lihen në vend, në përputhje me rregulloret në fuqi në shtetin e Përfituesit pas përfundimit të kontratës.

7. Personat fizikë dhe juridikë që importojnë pajisje profesionale, siç është parashikuar në artikullin 9, në qoftë se ata e kërkojnë një gjë të tillë, do të përfitojnë nga sistemi i pranimit të përkohshëm, siç përcaktohet nga legjislacioni kombëtar i Përfituesit në lidhje me pajisjet në fjalë.

KAPITULLI III REALIZIMI I KONTRATAVE

Neni 9 Origjina e furnizimeve

Përfituesi bie dakord që, përveçse kur autorizohet ndryshe nga Komisioni, materialet dhe pajisjet e kërkuara për realizimin e kontratave duhet ta kenë origjinën në Komunitet, në shtete përfituese sipas rregullores OBNOVA, rregullores CARDS, në vendet candidate për anëtarësim në Bashkimin Europian dhe, në rastin kur Komisioni ka autorizuar pjesëmarrjen në ftesat për tender dhe kontrata, në vendet përfituese sipas programit TACIS dhe MEDA, gjithashtu dhe në vendet e tjera.

Neni 10 Procedurat e pagesës

1. Për kontratat e financuara nga Granti i KE-së, tenderat do të hartohen dhe pagesat do të bëhen ose në euro, ose në përputhje me ligjet dhe rregulloret e këmbimit valutor të Përfituesit, në monedhën e Përfituesit, ose në monedhën e shtetit ku tenderuesi ka të regjistruar vendin e tij të biznesit, ose në monedhën e shtetit ku materialet janë prodhuar.

2. Kur tenderat janë bërë në euro, pagesat në lidhje me to do të bëhen, siç duhet, në monedhën e përcaktuar në kontratë mbi bazën e vlerës ekuivalente të euros në ditën e procedimit të pagesës.

KAPITULLI IV BASHKËPUNIMI NDËRMJET KOMISIONIT DHE PËRFITUESIT

Neni 11 Inspektimi dhe kontrolli

1. Komisioni, duke përfshirë dhe Zyrën Europiane Antievazion (OLAF), do të ketë të drejtën për të dërguar agjentët e saj ose përfaqësues të autorizuar për të realizuar çdo mision apo kontroll teknik dhe financiar që ai e konsideron të nevojshme, për të ndjekur realizimin e Masës. Megjithatë, komisioni do t'u japë autoriteteve të Përfituesit një lajmërim paraprak për misione të tilla.

Përfituesi do të japë të gjithë informacionin dhe dokumentet, të cilat do të kërkohen prej tij dhe do të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të lehtësuar punën e personave të instruktuar për të realizuar kontrollin ose inspektimin.

2. Përfituesi:

a) do të mirëmbajë të dhënat dhe llogaritë adekuate për të identifikuar punimet, furnizimet ose shërbimet e financuara sipas Marrëveshjes Financiare në përputhje me procedurat bazë të kontabilitetit;

b) do të sigurojë që agjentët e lartpërmendur ose përfaqësues të Komisionit kanë të drejtën për të inspektuar të gjitha dokumentet e nevojshme dhe llogaritë që i përkasin pikave të financuara sipas

Marrëveshjes Financiare dhe të ndihmojnë Gjykatën e Auditimit të Komuniteteve Europiane për të realizuar kontrollin në lidhje me përdorimin e Grant-it të KE-së.

Komisioni mund të realizojë gjithashtu një vlerësim ex-post dhe një kontroll përfundimtar të programit. Vlerësimi ex-post do të vlerësojë arritjet e objektivave/qëllimeve të programeve, gjithashtu dhe impaktin mbi zhvillimin dhe rristurimin e sektorit në fjalë.

Kontrolli përfundimtar do të rishikojë të dhënat financiare lokale të programit, duke dhënë një opinion të pavarur mbi saktësinë dhe përputhjen e kontratave, disbursimeve, gjithashtu dhe përputhshmërinë e saj me dispozitat e Marrëveshjes Financiare.

KAPITULLI V DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 12 Delegimi i zbatimit

Në zbatim të artikullit 4 të Marrëveshjes Kuadër, delegimi i përgjegjësisë të zbatimit tek një palë e tretë mund të bihet dakord përmes një shkëmbimi letrash ndërmjet Përfituesit dhe Komisionit Europian.

KAPITULLI VI DISPOZITAT E PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13 Konsultimet – Mosmarrëveshjet

1. Çdo çështje, në lidhje me realizimin ose interpretimin e Marrëveshjes Financiare ose të kushteve të përgjithshme, do të jetë subjekt i konsultimeve ndërmjet Përfituesit dhe Komisionit, duke çuar, kur është e nevojshme, në një amendament të Marrëveshjes Financiare.

2. Në rast të mospërbushjes së detyrimit të përcaktuar në Marrëveshjen Financiare dhe në kushtet e përgjithshme, e cila nuk ka qenë subjekt i masave rregulluese të marra në kohën e duhur, Komisioni mund të pezullojë financimin e Masës, pas konsultimeve me Përfituesin.

3. Përfituesi mund të mos pranojë në tërësi ose pjesërisht realizimin e Masës. Palët Kontraktuese do të përcaktojnë detajet e mospranimit në fjalë me një shkëmbim letrash.

Neni 14 Lajmërimi-adresat

Çdo lajmërim dhe çdo marrëveshje ndërmjet Palëve, të bërë për këtë qëllim, duhet të jetë subjekt i një komunikimi me shkrim duke iu referuar në mënyrë të përcaktuar numrit dhe titullit të Masës. Të tilla lajmërimet ose marrëveshjet do të bëhen me letra, të dërguara tek Pala e autorizuar për të marrë të njëjtën, dhe të dërguar në adresën e lajmëruar nga Pala në fjalë. Në rast urgjence, komunikimi me telefaks, telegraf ose teleks do të lejohet dhe do të gjykohej i vlefshëm, me kusht që të konfirmohen menjëherë me letër.

Adresat janë të përcaktuara në Marrëveshjen Financiare.

Aneksi B

ARBITRAZHI

Çdo marrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese, që del nga Marrëveshja Kuadër ose Marrëveshja Financiare, e cila nuk është zgjidhur duke zbatuar procedurat, e përcaktuara në artikullin 12 të kushteve të përgjithshme në lidhje me Marrëveshjen Financiare, do të shqyrtohet në arbitrazh nga një Tribunal Arbitrazhi, siç përcaktohet këtu poshtë.

Palë në një arbitrazh të tillë do të jenë Përfituesi nga njëra anë dhe Komisioni nga ana tjetër.

Tribunali i Arbitrazhit do të përbëhet nga tre arbitra të emëruar si më poshtë:- një arbitër të emëruar nga Përfituesi;

- një arbitër i dytë do të emërohet nga Komisioni;
- arbitri i tretë (këtë e tutje ndonjëherë do të thirret "Arbitri") do të emërohet me marrëveshje të Palëve, ose në qoftë se ato nuk bien dakord, nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.
Në qoftë se asnjëra nga Palët nuk arrin të emërojë një arbitër, Arbitri do të emërojë arbitra të tillë.

Nqs ndonjë nga arbitrat e emëruar në përputhje me këtë dispozitë heq dorë, vdes ose bëhet i paafte për të vepruar, një tjetër arbitër do të emërohet në të njëjtën mënyrë si arbitri, vendin e të cilit ai mori. Pasardhësi i tillë do të ketë të gjitha pushtetet dhe detyrimet e arbitrit të zëvendësuar.

Aneksi C
Përshkrimi i masave

Objektivat e programit

Objekti i përgjithshëm i asistencës së KE-së është përcaktuar brenda kuadrit të procesit të Stabilizim Asociimit (Sap) dhe përfshin konsolidimin e shtetit të së drejtës, stabilizimin demokratik, zhvillimin ekonomik dhe social dhe mbështetjen për mjedisin.

Objektivat specifike të programit janë:

- Drejtësia dhe çështjet e brendshme: të kontribuojnë në vendosjen e shtetit të së drejtës, stabilitet demokratik dhe në zhvillimin ekonomik me një fokus në ndërtimin e institucioneve, trajnimin dhe mbështetjen e investimeve.

- Ndërtimi i kapaciteteve administrative: të rrisë funksionimin e strukturave shtetërore dhe të mbështesë krijimin e një ekonomie tregu demokratike, funksionale brenda kuadrit të procesit të Stabilizim Asociimit.

- Zhvillimi ekonomik dhe social: të nxisë rritjen e sektorit privat dhe krijimin e vendeve të reja të punës, të nxisë zhvillimin e komunitetit lokal dhe të përmirësojë arsimin dhe trajnimin e mesëm dhe të lartë si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.

- Mbështetja e mbrojtjes së mjedisit: të forcojë kuadrin legjislativ në fushën e mjedisit dhe ta plotësojë këtë me dy skema pilot, që synojnë në mënyrë specifike në përmirësimin e mjedisit lokal përmes pjesëmarrjes së komunitetit.

- Stabilizimi demokratik: të forcojë shoqërinë civile përmes projekteve në shkallë të vogël.

Aktivitetet

Brenda programit të veprimit 2002, Programi indikativ shumëvjeçar për Shqipërinë është përcaktuar sipas objektivave të projekteve të mëposhtme:

1. Drejtësia dhe çështjet e brendshme

Aktivitetet e financuara në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme do të marrin parasysh rezultatet e misionit të vlerësimit të ekspertëve të Komisionit Europian dhe vendeve anëtare, realizuar këtë verë. Fishat në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme janë hartuar si korniza, të cilat do të jenë në gjendje të plotësojnë konkluzionet dhe rekomandimet e misionit të JHA-së.

Drejtësia

Të kontribuojë në krijimin e shtetit të së drejtës dhe stabilitet demokratik në Shqipëri përmes:

- forcimit të kapaciteteve të sistemit gjyqësor për të siguruar që ai të kthehet në një sistem eficient të pavarur dhe të besueshëm, bazuar në shtetin e së drejtës;

- forcimit të kuadrit legjislativ për paraburgim, dhe të përmirësimit të kushteve fizike të të ndaluarve përmes përmirësimit të banimit dhe të trajnimit më të mirë të stafit të paraburgimit.

Projekti do të realizohet përmes vendosjes së një misioni asistence për drejtësinë e KE-së, trajnimin dhe mbështetjen investuese përkatëse.

Policia dhe rendi publik

Të kontribuojë në krijimin e shtetit të së drejtës dhe në krijimin e një force policie funksionuese, që të jetë në gjendje për të kontribuar në stabilitetin demokratik përmes:

- kontributit për rendin publik në të gjithë vendin;

- forcimit të kapacitetit të autoriteteve shqiptare për të luftuar kundër krimit të organizuar, në veçanti kundër trafikëve ilegale (qenieve njerëzore, drogave, armëve dhe pastrimit të parave);

- vendosjes së marrëdhënieve të punës me shoqërinë civile.

Projekti do të realizohet përmes mbështetjes së një misioni asistence për policinë e KE-së,

trajnimin dhe mbështetjen investuese përkatëse.

Menaxhimi i integruar i kufijve

Të kontribuojë në krijimin e shtetit të së drejtës dhe në zhvillimin rajonal dhe kombëtar nëpërmjet ushtrimit të kontrollit efektiv të kufijve dhe lehtësimit të tregtisë përmes:

- përmirësimit të kuadrit rregullator, trajnimit dhe pajisjes me mjete të postave kufitare, përsa i përket kontrollit të kufijve;

- rritjes së kapaciteteve administrative dhe modernizimit të postave të caktuara kufitare, përsa i përket lehtësimit të tregtisë dhe trafikut;

- mbështetjes së përmirësimit të punëve infrastrukturore të identifikuar, përsa i përket nevojave të veçanta të kufijve rajonalë.

2. Ndërtimi i kapaciteteve administrative

Mbështetje për prokurimin publik

Të forcojë strukturat institucionale dhe kuadrin legjislativ ekzistues për një sistem prokurimi publik më të ndershëm dhe të hapur në Shqipëri përmes:

- forcimit të sistemit të rregullave të prokurimit publik;

- studimit të fizibilitetit dhe vullnetit për një strukturë certifikimi të veçantë për prokurimin dhe formulimin e një strategjie afatmesme për një strukturë të tillë;

- trajnimit të stafit dhe krijimit të një strukture trajnuese në Institutin Shqiptar të Administratës Publike;

- përmirësimit të cilësisë së të dhënave të mbledhura dhe të cilësisë së dokumenteve publike të tenderave dhe afateve të përgatitjes së tyre.

Konkurrenca dhe ndihma shtetërore

Të forcojë kapacitetin administrativ në Shqipëri në fushat e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore përmes:

- zhvillimit dhe forcimit të rregullave dhe rregulloreve të konkurrencës së ndershme;

- krijimit të një zyre të pavarur për konkurrencën dhe trajnimin e stafit të saj;

- formulimit të një strategjie afatmesme dhe rritjes së ndërgjegjësimit në fushat e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore.

Statistikat

Të forcojë sistemin statistikor në përputhje me nevojat e një shoqërie të orientuar nga demokracia dhe ekonomia e tregut, nëpërmjet sigurimit të një niveli të harmonizimit me metodat statistikore europiane dhe kërkesat e BE-së. E gjitha kjo përmes:

- mundësisit të përllogaritjeve të të dhënave kombëtare në përputhje me standardet ESA 95;

- rritjes së besueshmërisë në statistikat zyrtare;

- përafrimit me metodat statistikore të BE-së.

3. Zhvillimi ekonomik dhe social

Nxitja dhe lehtësimi i tregtisë

Të mbështesë lehtësimin dhe liberalizimin e tregtisë përmes:

- ndihmës në zbatimin e kërkesave të OBT-së;

- ndihmës në zbatimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit;

- harmonizimit të kuadrit ligjor me acquis të BE-së, standardet dhe praktikat;

- mbështetjes së tregtisë nëpërmjet tërheqjes së investimeve të huaja dhe zhvillimit të sektorëve kyç të shërbimeve.

Programi i VII i zhvillimit të komunitetit lokal

Të përmirësojë cilësinë e jetës në zonat rurale të Shqipërisë dhe të zhvillojë një ndërgjegjësim të komunitetit në këto fusha përmes:

- ndërtimit ose rehabilitimit të infrastrukturës lokale;

- përfshirjes së komuniteteve lokale në procesin e vendimmarrjes mbi këto projekte;

- përfshirjes së kontraktorëve lokalë për të realizuar punimet.

Tempus III

Të nxisë reformën e arsimit të lartë në Shqipëri nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së mësimin dhe mësimdhënies akademike në një linjë me ndryshimet e nevojave politike, sociale dhe ekonomike përmes:

- mbështetjes së politikave të arsimit të lartë;

- forcimit të lidhjeve me ekonominë lokale dhe rajonale;

- zhvillimit të kurrikulave në fushat prioritare për tranzicionin ekonomik dhe social;
- kontributit për lëvizjen e studentëve dhe stafit;
- forcimit të bashkëpunimit rajonal.

Mbështetje për reformën në trajnimin dhe arsimin profesional

Të kontribuojë në zhvillimin e një sistemi trajnimi dhe arsimit profesional (VET) që i përgjigjet nevojave në ndryshim të tregut të punës dhe zhvillimeve sociale përmes:

- kontributit në strategjinë e VET-it dhe zbatimit të një ligji të ri të VET-it;
- modernizimit të procesit mësimor të VET-it, sipas kërkesave të tregut, në një bazë pilot në nivel rajoni dhe shkolle.

4. Mjedisi dhe burimet natyrore

Legjislacioni mjedisor dhe rritja e ndërgjegjësimit

Të forcojë menaxhimin e mjedisit në Shqipëri, përmes një legjislacioni më të mirë dhe zbatim më të mirë të legjislacionit dhe përmes informimit më të mirë të popullsisë. Projekti do të punojë përmes:

- përgatitjes së ligjeve, akteve nënligjore dhe rregulloreve;
- zhvillimit të një projekti pilot mbi planifikimin mjedisor urban në një qytet turistik;
- rritjes së ndërgjegjësimit mbi çështjet mjedisore me qeverinë, parlamentin, publikun, fëmijët e shkollave, OJQ-të dhe shoqatat e biznesit;
- krijimit të një mekanizmi në nivel lokal për popullsinë për të marrë pjesë më aktivisht në planifikimin mjedisor.

Reduktimi i ndotjeve dhe kontrolli me rafinerinë e Ballshit

Të rehabilitojë një nga rafineritë e Shqipërisë, Ballshin, identifikuar nga shumë organizata kryesore si një ambient, që po degradon “hot spot”, për të modernizuar standardet e trajtimit të shkarkimit dhe magazinimit të naftës së mbetur përmes:

- projektimit, prokurimit dhe instalimit të një strukture filtruese për ndarjen e naftës nga uji në ujërat e ndotura;
- projektimit dhe ndërtimit të një fushe grumbulluese për mbetjet e naftës bazuar në normat e BE-së;

- rritjes së trajnimit dhe ndërgjegjësimit të stafit mbi çështjet mjedisore.

Projektimi i një vendi depozitimi të sigurt për mbetjet e rrezikshme

Të kontribuojnë në zgjidhjen e degradimit ambiental “hot spots” të vendeve të mbetjeve të rrezikshme përmes:

- mbështetjes në studimet tashmë të kryera, përzgjedhjes së një zone dhe projektimit të një vendi të sigurt për hedhjen e tyre;
- realizimit të një vlerësimi impakti mjedisor;
- sigurimit që legjislacioni i kërkuar nuk kundërshton ndërtimin dhe menaxhimin e vendit;
- identifikimit të pronësisë dhe strukturave menaxhuese dhe huadhënësit potencialë ndërkombëtar për ndërtimin e vendit, të hedhjes së mbeturinave.

5. Stabiliteti demokratik

Stabiliteti demokratik

Të forcojë dhe të zhvillojë kapacitetet e shoqërisë civile dhe të OJQ-ve në Shqipëri, të kontribuojë në rritjen e jetës bazë sociale, politike dhe të komunitetit përmes:

- forcimit të institucioneve dhe shoqatave lokale;
- dhënies së asistencës për grupet më pak të përkrahura të popullsisë;
- ndihmës për zhvillimin e shërbimeve të dhëna nga OJQ-të.

Projekti për stabilizimin demokratik do të japë grante për projektet e vogla. Ai do të plotësojë programin për zhvillimin e komuniteteve lokale dhe do të sigurojë një koordinim të ngushtë me aktivitetet të tjera bazë të lidhura me këtë, nga Bashkimi Europian dhe donatorë të tjerë.

Buxheti

Programi do të financohet përmes një granti të Komunitetit prej 44,9 milion Euro, të shpërndarë si më poshtë, ndërmjet sektorëve të ndryshëm:

1.Drejtësia dhe çështjet e brendshme	Euro 21.0
1.1 Reforma gjyqësore	Euro 8.0
1.2.Policia dhe krimi i organizuar	Euro 8.0

1.3 Menaxhimi i integruar i kufijve	Euro 5.0
2.Ndërtimi i kapaciteteve administrative	Euro 6.0
2.1 Prokurimi publik	Euro 3.0
2.2 Konkurrenca dhe ndihma shtetërore	Euro 2.0
2.3 Statistikat	Euro 1.0
3.Zhvillimi ekonomik dhe social	Euro 12.9
3.1 Tregtia	Euro 2.0
3.2 Zhvillimi i komunitetit lokal	Euro 7.4
3.3 Arsimi	Euro 3.5
4. Mjedisi dhe burimet natyrore	Euro 4.0
4.1 Mjedisi dhe burimet natyrore	Euro 4.0
5. Stabilizimi demokratik	Euro 1.0
5.1 Stabilizimi demokratik	Euro 1.0
TOTAL	44.9 milion Euro

Zbatimi

Kontratat e financuara sipas këtij programi do të hyjnë në fuqi jo më shpejt se firmosja e Memorandumit Financiar në formën e duhur nga nënshkruesit kompetentë dhe jo më vonë se 31.12.2005, të qenurit e skadencës së Memorandumit Financiar të asocuar. Për më tepër:

- Çdo grant ose kontratë përkatëse duhet të ketë hyrë në fuqi, pasi të jetë firmosur nga të gjitha Palët përkatëse, nga kjo datë skadence.

- Çdo grant ose kontratë që nuk ka hyrë në fuqi, pasi të jetë firmosur nga të gjitha Palët përkatëse nga datë skadence, nuk duhet të penalizohet, por do të anulohet dhe do të konsiderohet nul ose i pavlefshëm.

- Çdo sasi e fondeve sipas këtij programi që nuk është përdorur për të financuar kontratat ose grantet që janë në fuqi, nuk do të realizohet pas mbarimit të afatit të skadencës.

- Asnjë fond shtesë nga ky program, në çdo kontratë ose grant, nuk mund të hyjë në fuqi pas kësaj date skadence.

Afati pas së cilës të gjitha aktivitetet kontraktuale sipas këtij programi duhet të ndërpriten është jo më vonë se një vit kalendarik, pas datës së skadencës të Memorandumit Financiar përkatës. Për më tepër:

- Asnjë shtesë në çdo kontratë ose grant, financiar nga ky program, nuk duhet të hyjë në fuqi pas afatit të zbatimit.

Programi do të zbatohet nga shërbimet e Komisionit për/dhe në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet përkatëse nacionale dhe/ose lokale. Zbatimi i projektit do të kryhet nga shërbimet e Komisionit.

Monitorimi, vlerësimi dhe kontrolli

Ky program do të monitorohet dhe supervizohet nga shërbimet e Komisionit European, që:

a) do të monitorojnë zbatimin e programit mbi bazën e raporteve periodike, kontakteve me sipërmarrësit dhe vizitat në terren.

b) do të realizojnë monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm për të ndjekur progresin e programit dhe komponentët e tij, si dhe vlerësimin e ex-post pas përfundimit të tij.

Llogaritë dhe operimet në komponentët e programit do të kontrollohen në mënyrë periodike nga një revizor i jashtëm i kontraktuar nga Komisioni pa paragjykuar përgjegjësitë e Komisionit European, duke përfshirë Zyrën Europiane Antievasion (OLAF) dhe Gjykatën e Llogarive të Bashkimit European.

L I G J

Nr.9003, datë 13.2.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR PËR PROJEKTIN “FURNIZIMI ME UJË I ZONAVE FSHATARE TË KAVAJËS II – ZONA E MANSKURISË””

Commented [m1]:

Commented [m2]:

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për projektin “Furnizimi me ujë i zonave fshatare të Kavajës II – Zona e Manskurisë””, me një hua prej 1 553 875,64 Euro.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3717, datë 28.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

MARRËVESHJE

**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR**

(Furnizimi me ujë i zonave fshatare të Kavajës II – zona e Manskurisë)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;
duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë;
të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje,
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,
duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare gjermano-shqiptare të datës 5 dhjetor 2001, ranë dakord si vijon :

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt am Main, shumat e mëposhtme:

1) një hua me vlefë prej deri në eur 2.045.167,52 (dy milion e dyzet e pesë mijë njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë 52/100 euro) për projektin “Furnizimi me ujë i zonave fshatare të Kavajës II – zona e Manskurisë;

2) një shumë financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në pikën 1 me vlefë prej deri në eur 1.533.875,64 (një milion e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë 64/100 euro) për projektin “Furnizimi me ujë i zonave fshatare të Kavajës II - masa shoqëruese”, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur dhe pasi u konfirmua se ai plotëson kushtet e veçanta për mbështetje me anë të një shume financimi.

2. Po të merren vesh Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, projektet e përmendura në paragrafin 1 mund të zëvendësohen me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep

mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi, për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi, për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

4. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 1, pika 2 dhe paragrafit 3 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen ndërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe huamarrësve, si dhe marrësve të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1 paragrafi 1, pikat 1 dhe 2 do të zhvlehtësohen, në rast se kontrata përkatëse për huanë ose për financimin nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Afati për premtimin e shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1, pika 1 mbaron për shumën e pjesshme prej eur 766.937,82 (shtatëqind e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë 82/100 euro) më datë 31 dhjetor 2006, për shumën e pjesshme prej eur 1.278.229,70 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e nëntë 70/100 euro), më datë 31 dhjetor 2008. Afati për premtimin e shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 pika 2 mbaron, më datë 31 dhjetor 2005.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është huamarrëse, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratave që do të përfundohen sipas paragrafit 1.

3. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo nuk është marrëse e shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale për shlyerje, të cilat mund të lindin në bazë të kontratave për financim që do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huasë; nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 11 dhjetor në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

L I G J

Nr.9004, datë 13.2.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR PËR PROJEKTIN “FURNIZIMI ME UJË DHE SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË SHQIPËRINË E MESME, KOMPONENTËT BERAT DHE KUÇOVË””

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për projektin “Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Shqipërinë e Mesme, komponentët Berat dhe Kuçovë”, me një hua prej 6 646 794, 46 Euro.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3718 datë 28.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

MARRËVESHJE

**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR**

(“Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Shqipërinë e Mesme-komponentët Berat dhe Kuçovë”- për vitin 2000)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;
duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;
të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;
duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 23 qershor 2000
ranë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një hua me vlefë prej deri në 6.646.794,46 eur (gjashtë milionë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër 46/100 euro) për projektin “Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Shqipërinë e mesme-komponentët Berat dhe Kuçovë”, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur.

2. Po të merren vesh Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1, mund të zëvendësohet me projekte të tjera. Në

qoftë se projekti i përmendur në paragrafin 1 do të zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, duke qenë një projekt në fushën e mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale, ose një fond garantues i kredive për ndërmarrjet e mesme, ose një masë, e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave, ose një masë, e cila synon luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëdihmës, atëherë mund të jepet një shumë financimi, përndryshe mund të jepet një hua.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Qeverisë së Republikës së Shqipërisë t'i marrë Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi, për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma financimi, për masa të nevojshme shoqërore për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

4. Shumat e financimit për masat përgatitore dhe shoqërore sipas paragrafit 3, në rast se nuk përdoren për masa të tilla, do të kthehen në hua.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohet midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe huamarrësve, si dhe marrësve të shumës së financimit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvlehtësohet, në rast se kontrata përkatëse për huanë nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron, më datë 31 dhjetor 2008.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është huamarrëse, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratës që do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huasë; nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbyllur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 11 dhjetor në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 13.3.2003

Doli nga shtypi më 14.3.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë